



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 07.03.2022, ora 14:30

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektrezolutës “Për mbështetjen e sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Ukrainës dhe mbrojtjes e parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe të sigurisë europiane”

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Besion Ajazi, Tomor Alizoti, Hatixhe Konomi, Tritan Shehu, Ilirjan Pendavinji, Petro Koçi, Bardhyl Kollçaku, Kreshnik Çollaku, Taulant Balla, Blerina Gjylameti, Klodiana Spahiu.

Mungojnë:

Etjen Xhafaj, Lavdrim Krashi, Klodiana Spahiu, Blendi Klosi, Grida Duma, Alqi Bllako, Belind Këllici, Greta Bardeli, Shpëtim Idrizi, Benet Beci, Vangjel Dule.

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme të datës 7 mars 2022.

Meqë jemi në datën 7 mars, ju u uroj më të mirën të gjithë mësuesve, pedagogëve këtu prezent në këtë tryezë, si dhe të gjithë mësuesve dhe pedagogëve kudo që janë! Gëzuar 7 Marsin!

Jeni njoftuar që në rendin e ditës do të kemi shqyrtimin e dy projektrezolutave dhe të një amendimi. Ashtu siç edhe ju e dini fort mirë unë, do të filloj me një koment për projektrezolutën e propozuar nga kolegu Shehu dhe 7 kolegë të tjetër të opozitës, për shkak se është projektrezoluta e parë në kohë e depozituar në Kuvend.

Gjithashtu, dua të bëj një sqarim për të gjitha materialet dhe njoftimet që keni marrë në postën tuaj elektronike, ku me shumë të drejtë kërkesa e zotit Tritan Shehu dhe e kolegëve të tjerë konsiderohet një kërkesë mocion për debat. Kështu që, bazuar në nenin 98, pika 1 e Rregullores, mocioni me debat kalon për shqyrtimin në seancë plenare direkt, pa qenë nevoja që të kalojë në komision. Pra, ky propozim do të kalojë automatikisht në seancë plenare, ditën e enjte, ku, gjithashtu, do të shqyrtohet edhe projektrezoluta që ka ardhur si propozim i kryetarëve të grupeve parlamentare, njësoj si amendamenti i propozuar nga kolegu Vasili.

Me shumë të drejtë amendimi i propozuar nga kolegu Vasili bazohet në nenin 99, pika 3 e Rregullore së Kuvendit. Nëse doni, jua citoj: “Argumentimi i propozimit për amendim kalon direkt në seancë, dëgjohet, konsiderohet dhe votohet”, kështu që pavarësisht kësaj procedure, kemi nderin që kolegu Vasili është sot këtu në komision. Ky është komenti im lidhur me shqyrtimin e amendimit të propozuar nga kolegu Vasili, ndaj të dyja këto pika nuk do të kalojnë sot në mbledhje komisionit, por do të kalojnë direkt në seancë.

Vazhdojmë me rendin e ditës, ku kemi shqyrtimin e projektrezolutës “Për mbështetjen e sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Ukrainës dhe mbrojtjes e parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe të sigurisë europiane”, dakordësuar ndërmjet grupeve parlamentare.

Për ta prezantuar projektrezolutën, kam nderin t’i jap fjalën kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, zotit Balla.

Taulant fjala për ju.

Taulant Balla – Faleminderit kryetare!

Mimi Kodheli – Ndjesë, zoti Balla!

Sot kam marrë një propozim në mënyrë verbale nga kolegu Çollaku lidhur me një draftrezolutë, të cilin kolegu Çollaku kërkon të paraqesë. Sipas konsultimit me Drejtorinë Juridike të Kuvendit, duhet që ky propozim të ketë firmën e 7 kolegëve apo të grupit parlamentar, më pas të kalojë nga Konferenca e Kryetareve dhe brenda 3 ditëve nga marrja e njoftimit me shkrim të këtij propozimi kalon si mocion për debat, bazuar gjithmonë nënin 98, pika 1 ku është bazuar edhe propozimi i zotit Shehu. Pastaj vendoset nëse do të jetë mocion për debat apo do të kalojë nëpërmjet Komision për Politikën e Jashtme, siç po kalon edhe kjo projekrezolutë që po diskutojmë sot. Pra, brenda një afati kohor shumë të shkurtër, sido që të dakordësohemi në Konferencën e Kryetarëve, ne do ta kalojmë në një mbledhje tjetër të Komisionit për Politikën e Jashtme pa më të voglin problem.

Zoti Çollaku për procedurë.

Kreshnik Çollaku – Unë mendoj se projektrezoluta në lidhje me situatën e Ukrainës dhe draftrezoluta që unë po propozoj, ka lidhje dhe me atë që po ndodh në Ukrainë dhe me rrezikun e destabilitetit të Ballkanit, në mënyrë të theksuar, kjo është një situatë ku Kosova është vendi më i rrezikuar. Mendoj se praktikën procedurale mund ta zgjidhim shumë shpejt, qoftë për firmat, qoftë për depozitimin, por sens dhe logjikë ka, dhe unë ju kërkoj, që e njëjta draftrezolutë të kalojë në të njëjtën seancë bashkë me rezolutën për Ukrainën. Them se raste si ky nuk duhet të na pengojnë, për të shtyrë qoftë disa orë, qoftë një ditë, që t'i kalojmë të dyja bashkë në senacë, duke qenë se janë ngushtësisht të lidhura logjikisht me çfarë po ndodh në Ballkan dhe më tej.

Proceduralisht, firmat apo depozitimi janë gjëra që mund t'i realizojë shumë shpejt, por këtë e thashë për t'u trajtuar në komision, për të marrë mbështetjen ose ndonjë sugjerim tjetër.

Mimi Kodheli – Atëherë, ne mund të mbërrijmë ta kalojmë këtë projektrezolutë në seancën parlamentare të radhës. kolegu Çollaku. Ju keni gjithë kohën e nevojshme dhe të mundshme, që nga sot dhe deri të enjten, me përshpejtim të procedurave, që ta kemi të pranishme në seancë edhe këtë propozim, por jo pa asnjë procedurë, sepse në këtë komision mund të ngrihet kushdo dhe të propozojë një projektrezolutë tani. Kështu që, unë besoj se meqenëse është diçka që ia vlen, ne mund t'i përshpejtojmë proceduarat dhe jam plotësisht dakord me këtë që thoni ju, duke parë tematikën.

Mendoj se ju sot mund të realizoni firmosjen nga 7 deputetët apo nga kryetari i grupit parlamentar, të projektrezolutës së propozuar dhe pasi të diskutojmë edhe me Kryetaren e Kuvendit, mund ta kalojmë në komision, nëse ju nuk e doni mocion për debat në seancë

parlamentare, por e doni në këtë formë siç po kalojmë projektrezolutën e sotme. Nesër ose pasnesër, pavarësisht se nesër është një festë për zonjat, gjithsesi deri të mërkurën ose nesër në një orë të përshtatshme për të gjitha zonjat, mund ta bëjmë këtë gjë, por jo sot.

Domethënë, mund të përshpejtojmë procedurën, por jo të jetë një propozim për ditën e sotme. Sot do të diskutojmë projektrezolutën e dakordësuar midis 4 grupeve parlamentare. Ju jap fjalën se nga nesër, ne jemi të gatshëm, duke folur edhe Kryetaren e Kuvendit, duke folur edhe me kryetarët e grupeve, të mund ta kalojmë këtë projektrezolutë të enjten.

Kreshnik Çollaku – Ajo që duhet të na dominojë në këtë situatë është veprimi reaktiv i Parlamentit për atë që po ndodh. Kështu që, unë e kuptoj kujdesin tuaj për t’ia nënshkruar procedurës, por mendoj që vonesa e procedurës, e cila në fund të fundit është vetëm një vullnet porcedural, të cilin e realizojmë në më pak se një orë të gjithin, nuk duhet të na pengojë të ndajmë këto projektrezoluta, sepse mendoj që forcën e njëjës e merr rezoluta tjetër.

Kështu që jua kërkoj përsëri me shumë mirëkuptim dhe bonsens, të shtojmë një orë ose një ditë seancën, sepse sensin dhe forcën këto projektrezoluta e marrin kur janë të ndërlidhura bashkë në një seancë. Mendoj që nuk jemi në rutinë sjelljeje politike parlamentare normale, është një situatë e jashtëzakonshme që na prek drejtpërdrejt, Kosovën më shumë, dhe besoj që me pak bonsens, në respekt të procedurave dhe me procedurë, ta përshpejtojmë, jo ta anashkalojmë. Unë ju kërkoj që kjo të bëhet sot apo të shtyjmë edhe tjetrën dhe t’i bëjmë bashkë, se për sensin që kanë, ato duhet të kalojnë të dyja së bashku. Edhe forcën e marrin duke i kaluar së bashku, jo duke i trajtuar si çështje të ndara.

Mimi Kodheli – Forcën e marrin duke i kaluar së bashku në seancë parlamentare, këtë dua t’ju them. Kjo nuk do të thotë që duhet t’i kalojmë të dyja sot, mund t’i bëjmë të ndara dhe në seancë parlamentare shkojnë të dyja njëkohësisht për t’u diskutohen të dyja në seancë parlamentare.

Kjo që po them unë, nuk e prezumon faktin se nuk do të kalojnë të dyja në seancë parlamentar, por nuk do të kalojnë në mbledhjen e sotme të komisionit.

Patjetër, do të ketë Konferencë Kryetarësh, do flasim me Kryetaren, nëse mund të mbledhim një Konferencë Kryetarësh dhe ta kalojmë në seancë.

Tritan Shehu - Për procedurë, për të ndihmuar edhe kolegun Çollaku, ne kemi shtuar një rezolutë nga e cila preken edhe çështjet e rajonit, pikërisht si pasojë e destabilitetit që është krijuar nga agresioni rus ndaj Ukrainës, por që siç duket ka efekt më të gjerë. Unë e ftoj zotin

Çollaku të paraqesë një amendament për rezolutën tonë, atë që ai gjykon dhe kështu të ecim përpara së bashku. Në materialin zyrtar që më ka ardhur thuhet (e kam me zotin Çollaku dhe me zotin Tomorr), nuk e di nëse është vërtetë, që rezolutën e paraqitur nga Grupi i Partisë Socialiste (që është e drejta e saj dhe absolutisht s'kam asnjë problem), e ka miratuar edhe grupi i zotërinjtë që janë në krahun tim, opozita. Unë dua të di e ka miratuar edhe grupi i zotërinjve, që janë në krahun tim, që janë opozitë. Unë dua të di që nëse e kanë miratuar, është e kotë që ai grup të dalë me 2-3 rezoluta. Unë dua të di nëse e kanë miratuar këtë rezolutë, apo jo. Nëse e kanë miratuar, nuk keni se çfarë të kërkon, zotëri i dashur. Nëse nuk e keni miratuar, unë u bëj thirrje të dilni me amendamente, krahas rezolutës sonë sot dhe ejani të luftojmë së bashku për problemet që lidhen me Ballkanin. Jo të luftojmë së bashku, t'i ngremë së bashku këto probleme, desha të them.

Mimi Kodheli – Të falënderoj, zoti Shehu!

Zoti Balla e ka fjalën për procedurë.

Taulant Balla – Zoti Shehu, nuk ka një rezolutë të njëanshme të propozuar. Nisur nga rëndësia e çështjes, nisur nga fakti që nga Parlamenti Europian te Kongresi Amerikan, te kuvendet, apo parlamentet e shumë vendeve aleate, natyrshëm edhe Kuvendi i Shqipërisë nuk mund të qëndronte i heshtur.

Në diskutimet që janë zhvilluar në Konferencën e fundit të Kryetarëve, nga kolegë deputetë të opozitës, kryetarë të grupeve parlamentare të opozitës, kujtoj që janë 3 kryetarë të grupeve parlamentare të opozitës, është hedhur diskutimi dhe është rënë dakord për një tekst të përbashkët të një rezolute. Më lejoni t'jua kujtoj që institucioni më i lartë i Kuvendit në këtë aspekt është Konferenca e Kryetarëve, ku është dakordësuar të konsultohemi edhe me Ministrinë e Jashtme për hartimin e një rezolute të përbashkët.

Kjo nuk është një rezolutë e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste. Unë gjej rastin të falënderoj 3 kryetarët e grupeve parlamentare, zotin Alibeaj, zonjën Doda dhe zotin Mediu, me të cilët kemi komunikuar natyrshëm, që secili prej kryetarëve të grupeve parlamentare ka caktuar deputetë të tjerë brenda grupeve respektive për të negociuar një dokument të përbashkët. Kjo është një traditë e kahershme parlamentare mes grupeve parlamentare, dhe fakti është që janë të katër grupet parlamentare ekzistuese në Kuvend që kanë dakordësuar këtë tekst, ku është punuar natyrshëm me fokusin për të përshpejtuar punën.

Fakti që javën e kaluar Kuvendi ishte në atë që është quajtur “Java e gjelbër” edhe për shkak të angazhimit të deputetëve në territor, seanca e parë, që zhvillohet është seanca e ditës së hënë, përcaktuar nga ndryshimet në Rregullore në vitin 2019.

Unë do t’ju kërkoja, në përgjegjësinë e momentit në të cilin jemi, në asnjë lloj oportuniteti politik të momentit, që ta tejkalojmë diskutimin për të penguar kalimin e kësaj rezolute sot.

Bie po ashtu dakord që ka plot këndvështrime qoftë për çështjen e mbështetjes së sovranitetit territorial të Ukrainës, qoftë për kundërshtimin apo dënimin e agresionit rus, natyrshëm këtu shtohet edhe ajo që është propozuar, një pozicionim i Kuvendit të Shqipërisë lidhur me Kosovën, me rrugën e saj europiane, me rrugën e saj të integriteteve euroatlantike, por nuk besoj se këto janë çështje, që ne mund t’i bashkojmë sot.

Kuvendi i Shqipërisë, ky është viti im i 17-të, mesa kujtoj unë, ka edhe rezolute të tjera, që kanë të bëjnë me pozicionin e qartë të Shqipërisë për mbështetjen e rrugës së integriteteve euroatlantike të Kosovës, të cilat duhen cituar, duhen tërhequr nga arkivi i Kuvendit, duhet marrë informacion se çfarë hapash ka ndërmarrë qeveria shqiptare, si institucioni përgjegjës primar për zbatimin e rezolutave. Në këtë këndvështrim, unë mendoj që 7 deputetë apo një kryetar grupi parlamentar ka të gjithë të drejtën të propozojë mocione me debat, të cilat në fund, thuhet në Rregullore, shoqërohen me rezolutën.

Në rastin në fjalë, e njëjta praktikë që ka ndodhur edhe në Parlamentin Europian, apo në parlamente të tjera, në momentin, që është arritur një dakordësi e plotë nga të gjitha grupet parlamentare, le të ecim përpara. Natyrshëm që sipas të njëjtit model unë do të propozoja që ky dokument i sapropozuar të na vihet edhe neve në dispozicion dhe të mos vijë si një firmë 7 deputetësh të një grupi, por të vijë me të njëjtën mbështetje të 4 grupeve parlamentare ekzistuese në Kuvendin e Shqipërisë.

Unë jam shumë i bindur që mund dhe duhet ta gjejmë gjuhën edhe në rastin në fjalë, por nuk mund të humbim as edhe një minutë nga sot, për të mos u pozicionuar qartë ne si Kuvend i Shqipërisë, për rastin e asaj që ka ndodhur, po ndodh dhe vijon të ndodhë në Ukrainë, madje jemi të vonuar dhe këtu e bëj edhe veten time fajtor. Pamundësia e Kuvendit për t’u mbledhur javën e kaluar e ka vonuar disi, por në fund të fundit të kemi parasysh që rendi i ditës i Kuvendit të Shqipërisë është njoftuar, është bërë publik dhe do të ishte një gabim trashanik nga ana jonë që ne të shtynim seancën për të miratuar diçka, që asnjëri nga ne në këtë sallë nuk është kundër. Pra,

të gjithë jemi pro kësaj gjëje dhe në rast se dilte lajmi, që do të nxirrte Kuvendi i Shqipërisë sot, që shtyhet seanca, anulohet seanca, në të cilën do të miratohet rezoluta për mbështetjen e sovranitetit të tërësisë territoriale të Ukrainës dhe mbrojtjen e parimeve të së drejtës ndërkombëtare të sigurisë europiane, ky do të ishte jo një lajm i keq, por unë do ta quaja gabim trashanik i secilit prej nesh, i kujtdo që do të binte dakord me këtë kërkesë.

Për sa u përket projektrezolutave të tjera, se u njoha edhe me projektrezolutën që ka ardhur nga 7 deputetë, ku ndër ta është edhe zoti Shehu, ajo të kalojë në Konferencën e Kryetarëve, të caktohet data e thirrjes së seancës dhe patjetër edhe ajo të shqyrtohet në Kuvend.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tritan Shehu – Mua më vjen mirë dhe të falënderoj...

Mimi Kodheli – Zoti Shehu, të lutem, është zoti Vasili dhe pastaj ju.

Tritan Shehu – E kam unë fjalën për procedurë.

Mimi Kodheli – Edhe zoti Vasili për procedurë e ka fjalën.

Tritan Shehu – Ngaqë më përmendi edhe zoti Balla.

Mimi Kodheli – Për procedurë nuk ka nevojë t'i përgjigjesh zotit Balla. Radhën e ka zoti Vasili dhe pastaj ju.

Tritan Shehu – Nuk kam përgjigje, madje e mirëkuptoj zotin Balla.

Mimi Kodheli – Zoti Shehu, të lutem!

Fjalën e ka zoti Vasili.

Petrit Vasili – Zonja kryetare, unë desha të sqarojmë pak situatën në të cilën ndodhemi sot. Unë sot ndodhem në këtë komision i ftuar nga ju dhe në rendin tuaj të ditës thuhet: shqyrtimi i amendamentit përkatës.

Unë, me shumë mirëkuptim, nuk e konsideroj dot që është një lajthitje dhe këtu dëgjoj që kjo do të shkojë në seancë plenare. Në rast se do të shkonte në seancë plenare, pse ndodhet në rendin e ditës shqyrtimi dhe pse ndodhem unë këtu? Kjo është e para.

E dyta, të flasim midis nesh, ne nuk jemi në kushtet e një procedure, ashtu sikur thuhet edhe në Rregullore. Ju keni kryetaren e grupit parlamentar dhe në rast se ka ndonjë pikë, që nuk është e saktë nga këto që them, le të më korrigjojë. Ju e dini që ky diskutim për këtë projektrezolutë duhet të kishte mbaruar ditë më parë dhe 2 ditë më parë ne duhet të kishim tekstin e saj për të pasur mundësi të diskutonim edhe në sallën e Kuvendit apo të jepnim opinionin tonë.

Projektrezoluta do të marrë bekimin e komisionit, duam s' duam ne, për t'u shqyrtuar në orën 17:00 dhe thënë e gjithë kjo nuk jemi në kushtet e një procedure, e kuptojmë emergjencën. Kur kuptojmë emergjencën dhe kur kuptojmë që duhet një debat, unë sinqerisht po them, që në planin politik dhe personal, nuk mendoj se do të ketë tabu të “Javës së gjelbër”, kur ky parlament është provuar që është mbledhur edhe për gjëra minore, jo për një gjë kaq të madhe, edhe jashtë radhës. Nuk dua t'ju marr kohë t'ju numëroj një mori rastesh, por nuk është fare as përgjegjësia juaj si kryetare, është e vetë organizimit të parlamentit. E thënë e gjithë kjo, në rast se do të shkëmbejmë 2-3 opinione, edhe unë, edhe zoti Shehu, disa minuta për të folur me komisionin, do të më dukej gjëja më normale në botë, ndërkohë që erdhët këtu dhe na fusni në një procedurë shumë strikte, kur nuk jemi në kushtet e një procedure të tillë, nga vetë ju. Kështu do të thosha që, në respekt të kësaj, që ndodhemi këtu, meqë jemi kolegë të barabartë, ju jeni në komision, mund të vini për një çështje të caktuar në komisionet ku bëjmë pjesë ne dhe të njëjtin mirëkuptim do të gjenit dhe them nuk do të ishte e udhës, meqë diskutojmë një çështje kaq të sensitive, po e ndajmë të gjithë që çështja është kaq sensitive sa s'ka, të kemi ekonominë e madhe të procedurës, sa të mos kemi mundësinë të prononcohemi sadopak.

Mimi Kodheli – Zoti Vasili, jeni i mirëpritur në këtë komision dhe ju e dini shumë mirë këtë gjë, kështu që nëse ju keni diçka për të komentuar qoftë edhe në lidhje me amendimin, që ju keni prezantuar, jeni më shumë sesa i mirëpritur ta bëni këtë gjë, nuk është fare problem. Pra, e konsideroj të tejkualuar komentin tuaj të mëparshëm.

Zoti Shehu dhe më pas zoti Çollaku e kanë fjalën për procedurë.

Tritan Shehu – Faleminderit, zonja kryetare!

Mua më vjen mirë sinqerisht që zoti Balla sot e pranon që është me vonesë në këtë proces, që kemi bërë. Unë kam një javë, kam disa ditë që e kam kërkuar edhe në seancë plenare, edhe këtu që të miratojmë një rezolutë për çështjen e agresionit rus në Ukrainë dhe nuk është rënë dakord as të fillonim procedurën, madje kam thënë edhe këtë gjë, zoti Balla: ejani të ulemi së bashku, të bëjmë një tekst të pranueshëm për të gjithë, ta paraqesim dhe të dalim të gjithë me një tekst të përbashkët. Këtë e kam thënë edhe në seancë plenare, edhe në komisionin.

Fatkeqësisht, ka pasur një heshtje të plotë për këtë punë. Më vonë ju dëgjova ju në media, se është e drejta juaj, dhe unë ju respektoj totalisht në të drejtën tuaj, kur thatë: “Ne, si Grup i Partisë Socialiste, kemi përgatitur një draftrezolutë (e thatë në media dhe dëgjova me veshët e mi) dhe po ua shpërndajmë të gjitha grupeve parlamentare për të dakordësuar.” Në rregull, nuk

ka asgjë të keqe këtu; jeni krejtësisht në të drejtën tuaj për këtë gjë. Nuk ka asgjë të keqe. Pra, sot e pranojmë se jemi me vonesë, jemi edhe jashtë kohës së procedurës reale, sepse sot në orën 17:00 është në rendin e ditës, janë të dyja, edhe kjo juaja dhe ajo jona, pra e një grupi prej 7 deputetësh. Në këto kushte, çfarë do të bëjmë, zoti Balla? Unë ju pyes ju direkt, nuk pyes kolegët e tjerë, a doni të bëjmë një kompromis? Po ju pyes shumë sinqerisht. A jeni të hapur...

Mimi Kodheli – Zoti Shehu, deri tani po flisnim për procedurë.

Tritan Shehu – Po, për procedurë po flas unë, kompromisi është pjesë e procedurës. A jeni të hapur të ulemi dhe të bëjmë realisht një rezolutë të përbashkët? Unë jam deputet i parlamentit shqiptar; jam edhe iniciator së bashku me 7 kolegë të tjerë.

Mimi Kodheli – Zoti Shehu, të lutem, pyetjen e bëtë dhe do të keni përgjigje nga zotërinjtë.

Tritan Shehu – Shpreh gatishmërinë time dhe të kolegëve të tjerë, në qoftë se ju dëshironi dhe keni hapësirë reale, hajdeni të ulemi dhe të bëjmë diçka të përbashkët, por, nga ana tjetër, sinqerisht, atë material që ju keni paraqitur... Unë nuk kam gjë me objeksionet tuaja, ju keni të drejtën tuaj., unë e kam me kolegët e mi të opozitës, sepse në atë material nuk ngrihet asnjë çështje, asnjë element për rajonin, përkundrazi mbështetet qeveria, thuhet shprehimisht se mbështetet qeveria, nuk thuhet vetëm nxitet qeveria, por mbështetet. Unë dua të di nga kolegët opozitës, a e kanë miratuar atë draft sot për sot, sepse është thënë se është miratuar? Në qoftë se ju dëshironi gatishmërinë time për t'u ulur dhe për të bërë diçka të përbashkët, në emër të kolegëve që kanë paraqitur këtë material, e keni. Si të dëshironi?

Mimi Kodheli – Zoti Shehu, të lutem, kërkoj vetëm diçka, kolegë, të mos kalojmë në përsëritje të pyetjeve apo të komenteve, së pari, sepse kemi seancë plenare në orën 17:00.

Së dyti, sot ka qenë një ditë e ngjeshur dhe do të vazhdojë të jetë një ditë e ngjeshur edhe për shkak të datës së veçantë, në të cilën jemi sot.

Zoti Balla, ka një koment zoti Çollaku për procedurë, më pas jua jap fjalën juve. Në rregull.

Zoti Çollaku.

Kreshnik Çollaku – Faleminderit, zonja kryetare!

Kam një përgjigje për pyetjet që miqtë dhe kolegët e mi kanë, ndoshta, edhe paqartësisë, por nuk besoj se është paqartësi.

Në mbledhjen e MSA-së që kishim ditën kur u zhvillua sulmi i parë i Rusisë në Ukrainë, unë kam kërkuar në fjalën që mbajtja atje, nuk e di a ndodhte sulmi, sepse fjala ime ka ndodhur disa orë pas sulmit, u kam kërkuar të gjithë deputetëve të pranishëm, edhe eurodeputetëve, edhe kryetarit të grupit, që ishte i pranishëm, i kam kërkuar që parlamentit të Shqipërisë në këtë histori, ngjarja më të rëndë në Europë, pas Luftës së Dytë Botërore, të mbajë qëndrime të unifikuara, sepse është një ngjarje shumë e rëndë për Europën. Paralel me këtë kërkesë që kam bërë atje në bindjen time edhe gjatë fjalës sime, kemi filluar si grup, kërkuar nga kryetari i grupit, përgatitjen e një draftrezolutive për çështjen e Ukrainës. Gjithashtu, m'u komunikua se edhe nga grupet e tjera ka një vullnet për të përgatitur një draftrezolutë. Nga grupi i maxhorancës janë caktuar personat për të draftuar rezolutën. Unë kam përgatitur rezolutën tonë të konsultuar me kryetarin e grupit. Projektrezoluta që paraqitet sot, nuk është e maxhorancës, nuk është e një pale, është një draft, një tekst i përbashkët i draftuar nga të gjithë dhe në një tekst të draftuar nga të gjithë, sigurisht, është përpjekje për të pasur një qëndrim të unifikuar, jo për të shprehur opinionet tona në lidhje me ato që ju thatë për "*Open Balkan*" apo për të tjerat, për të cilat unë jam, ndoshta, në rekorde nga personat që e ka përmendur apo e ka kërkuar apo goditur më shumë qoftë në seancat përpara qeverisë, qoftë në debatin publik. Pra, drafti që sot po diskutojmë, është një drafttekst i dakordësuar ndërmjet grupeve, nuk është i asnjërit grup dhe do të ishte mirë që të mos ishte i asnjërit grup në mënyrë specifike. Sigurisht, kur dakordëson një draft, duhet të biesh dakord me të gjitha palët për të pasur një draft të përbashkët. Kështu që kjo është historia e draftit që sot ju paraqitet, nuk është i maxhorancës, nuk është i një grupi. Do të doja të ishte edhe yni totalisht, sigurisht diku teksti duhej të përshtatej për të mbërritur në konsensus. Kjo është historia e kësaj sot.

Zonja kryetare, unë vazhdoj të insistoj se për draftrezolutën që po paraqes, firmat janë të gatshme, procedura është dhe mund të bëhet e përsheptuar. Unë kërkoj që kjo të depozitohet sot dhe nuk na gjen gjë në qoftë se bëhet një mbledhje e kryesisë sot apo të përsheptojmë procedurën dhe të paraqiten bashkë me rezolutën për Ukrainën edhe rezoluta në mbështetje të Kosovës për pozicionin e Kosovës. Nuk keni asnjë lloj pengese procedurale për këtë, firmat janë të gatshme, aktet, të cilat i duhen një mbledhje, dhe diskutimin këtu mund ta bëjmë paralelisht; nuk kam asnjë lloj problemi në këtë gjë. Kolegët mund të japin mendime, mund të bashkëngjiten, sepse e mira do të ishte që këto të votoheshin me 140 vota në seancë, sepse është e paprecedent që ne të kemi ndarje në këto tema. Problemi është se vonesa për të pasur avantazhe të vogla të

natyrës partiake apo grupesh, nuk na shërben në këtë rast, është një situatë emergjente. Kosova është një situatë emergjente, rreziku është emergjent. Ne duhet të reagojmë si për Ukrainën, edhe Kosovën në të njëjtën seancë. Kjo u jep forcë të dyja qëndrimeve tona. Procedura nuk na pengon, sepse firmat janë gati, jemi të njohur dhe ta realizojmë këtë gjë.

Unë insistoj në këtë gjë dhe, ju lutem, mirëkuptojeni, se nuk kam asnjë lloj beteje partiake politike apo grupesh. Është një gjë që na shkon ta bëjmë bashkë.

Mimi Kodheli – Zoti Çollaku, unë ju mirëkuptoj, ashtu siç ju duhet të mirëkuptoni mua që nuk mund të marr tagrin e një seancë plenare apo të një Konferencë Kryetarësh. Kjo është pak, por e sigurt.

Fjalën e ka zotit Taulant Balla për prezantimin dhe më pas nënkryetari, Alizoti.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kolegu Alizoti, të lutem, që ta fillojmë mbledhjen! Deri tani ishim te procedura.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për procedurë?

Urdhëroni!

Tomor Alizoti – Politika e jashtme është një kapital i madh për çdo vend në botë dhe që ne po e përdorim në këtë lloj mënyre, mua nuk më pëlqen. Parlamenti duhet të mbledhet më shpejt, sepse është vonë. Unë jam nënkryetar i këtij komisioni dhe nuk jam bërë me dije për këtë rezolutë, dhe ky nuk është problemi juaj, por po e diskutojmë si shqiptarë. Unë nuk di gjë për projektrezolutën, zoti Çollaku, jam nënkryetar i komisionit dhe duhej të vij, se vij nga zanati i diplomacisë, sepse i kuptoj disa elemente, pra duhej ta kishim diskutuar këtë gjë, sepse bëhet për një qëndrim që ka të bëjë mbi Shqipërinë. Shqipëria qëndron mbi të gjitha interesat e të gjithëve ne. Ne mund të kemi mendime të ndryshme si do ta rregullojmë Shqipërinë, ka të majtë dhe të djathtë, të bardhë dhe të zinj, por ne në komision, të paktën ky mund të jetë problemi unë, jo juaji, por flas, meqenëse është diçka që u përket të gjithë shqiptarëve, unë si nënkryetar i komisionit këtu nuk kam asnjë gjë në dorë, nuk di çfarë vjen nga PD-ja; ju duhej të ma kishit nisur mua këtë projektrezolutë.

Mimi Kodheli – Zoti nënkryetar, unë ndaj të njëjtin shqetësim me ju dhe i bashkohem shqetësimit tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tomor Alizoti – Unë do të mbaj një qëndrim për Ukrainën, si t'ia bëj unë.

Mimi Kodheli – Unë i bashkohem shqetësimit tuaj, por është një problem që nuk i takon as kësaj tryeze, ky është një problem që i takon anës së djathtë të tryezës.

Zoti Balla, fjala për ju.

Taulant Balla – Zonja kryetare,

Kolegë deputetë,

Në parantezë të leximit para Komisionit të Politikës së Jashtme të Kuvendit të Shqipërisë të draftrezolutës së dakordësuar mes 4 grupeve parlamentare, nënvizoj faktin që gjithçka, që konfirmoi zoti Çollaku, është e vërtetë. Edhe në Komitetin Parlamentar të Stabilizim-Asociimit është propozuar nga ana e kolegut të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike nevoja e mbajtjes së një qëndrimi që në atë moment dhe po aty u dakordësua që për këtë çështje nuk mund të shpreheshim në Komitetin Parlamentar të Stabilizim-Asociimit, por të shpreheshim në Kuvendin e Shqipërisë.

Projektrezoluta “Për mbështetjen e sovranitetit e tërësisë territoriale të Ukrainës dhe mbrojtjen e parimeve të së drejtës ndërkombëtarë dhe të sigurisë europiane”, duke u bazuar në Kartën e Kombeve të Bashkuara, Aktin Final i Helsinkit dhe dokumentet e OSBE-së, që e kanë pasur atë, memorandumit të Budapestit të vitit 1994 mbi garancitë e siguresë lidhur me aderimin e Ukrainës në traktatin mospërhapjes së armëve bërthamore, marrëveshjet e Minskut të vitit 2014 dhe paketën e masave në zbatim të tyre, të nënshkruara në vitin 2015, duke shprehur shqetësim të thellë për faktin se vlerat e bashkëjetesës paqësore mes popullit, demokracia dhe të drejtat e njeriut, të promovuar në Europë dhe në botë pas Luftës së Dytë Botërore janë cenuar rëndë nga agresioni ushtarak i Federatës Ruse kundër Ukrainës.

Në mbështetje të sovranitetit, tërësisë territoriale dhe zhvillimit demokratik të Ukrainës, në mbështetje të plotë të qëndrimit të vendeve të tjera në të gjithë botën, që aspirojnë dhe mbrojnë vlerat demokratike, në përputhje të plotë me politikën e jashtme të sigurisë së Bashkimit Europian, përfshirë vendimet e Bashkimit Europian për masa shtrënguese, në respekt dhe nën përgjegjësinë e rolit të Shqipërisë si anëtar jo i përhershëm i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për periudhën 2022-2023, duke marrë në konsideratë rrezikun e ndikimit në rajonin tonë të agresionit rus në Ukrainë, me pasojë demotivimin e perspektivës euroatlantike të rajonit për ruajtje të sigurisë dhe stabilitetit në Europë, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dënon me forcë agresionin ushtarak rus në Ukrainë dhe shkeljen e rëndë nga ana e Federatës Ruse të sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Ukrainës, si një akt që dhunon rendin ndërkombëtar, duke

shkelur hapur dhe në mënyrë flagrante Kartën e Kombeve të Bashkuara, Aktin Final të Helsinkit, memorandumit e Budapestit, marrëveshjet e Minskut, si dhe një sërë dokumentesh të tjera ndërkombëtare dhe dypalëshe që Rusia ka firmosur me vullnet të lirë; nxit dhe mbështet veprimtarinë diplomatike dhe masat e ndërmarra nga qeveria shqiptare, në bashkërendim me aleatët tanë strategjikë, SHBA-të dhe BE-në, në mbështetje të sovranitetit të Ukrainës dhe të parimeve të sigurisë europiane dhe rendit global të marrëdhënieve midis shteteve; mbështet sanksionet ekonomike dhe masat diplomatike të ndërmarra nga partnerët strategjikë ndaj Federatës Ruse dhe ndihmën ushtarake e humanitare për Ukrainën dhe popullin e saj; bën thirrje për ndalimin e menjëhershëm të përdorimit të forcës nga Federata Ruse në Ukrainë dhe për tërheqjen e forcave ushtarake ruse nga territori i Ukrainës, sipas kufijve të njohur ndërkombëtarisht, dënon me forcë agresionin ushtarak rus ndaj Ukrainës, duke vlerësuar se aktet kundër civilëve të pafajshëm janë krime lufte dhe se shkaktarët e këtij agresioni duhet të përballen me Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Kuvendi i kërkon qeverisë të vazhdojë angazhimin në bashkërendim të ngushtë me të gjitha vendet aleate dhe partnere në NATO, BE, Këshill të Sigurimit të OKB-së, OSBE, Këshilli i Europës në rajonin e Ballkanit dhe me partnerët e tjerë, në mbështetje të sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Ukrainës dhe të parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe të sigurisë europiane.

T'i forcojmë me prioritet përpjekjet për integrimin europian të vendit dhe rajonit, si mbështetje e pazëvendësueshme për ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit në Europë.

Ky është drafti i dakordësuar mes 4 grupeve parlamentare. E nënvizoj edhe një herë se është një dokument që është konsultuar natyrshëm, sikurse çdo vend normal, edhe me gjuhën diplomatike të nevojshme të Ministrisë së Jashtme dhe besoj se ky dokument meriton t'i kalojë për shqyrtim seancës plenare, sipas procedurës së përcaktuar në Rregulloren e Kuvendit.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, kryetarit Balla!

Zoti Vasili, fjala për ju.

Petrit Vasili – Faleminderit, zonja kryetare!

Po qëndroj shumë telegrafikisht tek thelbi i amendamentit të propozuar, duke pasur gjithmonë si bazë dokumentin që zoti Balla paraqiti, për më shumë si një dokument i dakordësuar gjerësisht, të paktën sikurse u referua këtu.

Do të qëndroja vetëm tek tri momente. Në këtë moment ne kemi një pozicion vërtet shumë të veçantë në Ballkanin Perëndimor dhe duhet ta vlerësojmë në këtë kontekst, në të cilin ndodhen bota dhe Shqipëria për një arsye shumë të thjeshtë, për shkak të pozicionit gjeostrategjik që ne kemi, dy elementet thelbësorë që ne mund të investojmë në këtë çështje është principlialiteti dhe luajaliteti.

Principlialiteti ka të bëjë pikërisht me si qëndrojnë problemet në parim dhe luajaliteti është se sa të ndershëm jemi ne në raportet tona me aleatët tonë euroatlantikë. Në rastin konkret, amendamenti ka të bëjë me një veprim konkret, të drejtpërdrejtë, të menjëhershëm, të imponuar në një situatë të re në mënyrë shumë të veçantë siç është çështja e “Ballkanit të hapur”, çështje e cila ka qenë thellësisht e kritikuar, thellësisht e kontestuar për një mijë arsye të karakterit politik, të karakterit ekonomik dhe të çështjeve që kanë të bëjnë me sigurinë në rajon, në mënyrë të veçantë në Ballkanin Perëndimor.

Shqetësimi është, sepse ne kemi ndërtuar një marrëdhënie preferenciale të njëanshme, të kritikuar gjerësisht si një marrëdhënie gjysmake dhe në mënyrë të veçantë një marrëdhënie, ku mbani pozicioni më të gabuar të mundshëm dhe më të keq të mundshëm në lidhje me Kosovën e, kur nën dritën e këtyre zhvillimeve të reja, një pozicion i tillë, sigurisht, është i pamundur të vazhdojë qoftë edhe 1 minutë më tej, pasi është shumë e qartë që kemi të bëjmë me një marrëdhënie preferenciale, shumë të veçantë, shumë të njëanshme me të vetmin shtet evropian që nuk u është bashkuar sanksioneve ndërkombëtare të BE-së dhe të SHBA-ve.

Situata është kaq e vërtetë dhe kaq e tensionuar në Ballkanin Perëndimor, sa që ju jeni shumë mirë e informuar që 19 kongresmenë, të majtë dhe të djathtë, në Amerikës i janë drejtuar Presidentit Biden pikërisht për situatën e re në Ballkanin Perëndimor dhe për çështje të destabilizimit. Ndërtimi i marrëdhënieve preferenciale me Serbinë në kuadrin e “Ballkanit të hapur, si një vend i cili jo vetëm që është i vetmi që nuk iu kundërvu sanksioneve, por është i vetmi vend në Ballkan, sipas përcaktimeve të fundit të qeverisë ruse, që nuk bën pjesë te vendet jomiqësore, pra vendet të cilat janë ballë për ballë me Rusinë, siç jemi ne, Mali i Zi, Maqedonia, nuk llogarisim vendet e BE-së, sepse ato janë të gjitha në listën e vendeve jomiqësore.

Së treti, është i vetmi vend ku manifestohet pro luftës, ashtu sikurse nuk manifestohet as në Moskë, ku njerëzit po arrestohen, është i vetmi vend ku në raport me Kosovën, maxhorancë dhe opozitë, janë në një mendje dhe, po të lexoni deklaratimet e fundit të kandidatit për president të opozitës së bashkuar lidhur me Kosovën, janë po aq ekstremiste dhe të egra, sa edhe vetë

Vuçiçi. Kemi të bëjmë me një vend ku, përveç Presidentit, figura e dytë e shteti, Kryetari i parlamentit, shprehet qartë: Rusia është mbrojtësja e vetme jona dhe ne s'kemi ku mbështetemi tjetër, por do ta mbështesim me ç'të jetë, se kemi këto interesa prioritare dhe s'kemi të tjera. Në këtë pikëpamje, është e pamundur që ne, në rast se duhet të jemi principialë dhe luajalë, të mos ndërmarrim të vetmin veprim konkret që kemi në dorë të bëjmë.

Shumë shtete të tjera nuk i kanë diskutuar dhe vënë në diskutim fare interesa ekonomike me miliarda që kanë lidhur për shkak të shkëmbimeve ekonomike me Rusinë, por momenti i ndarjes së madhe midis atyre, që janë agresorë dhe atyre që duan paqen është një vijë ndarëse, së cilës nuk mund t'i devijojë askush dhe për të cilën duhen ndërmarrë veprime konkrete. Ndërkohë që nëse vazhdojmë këtë marrëdhënie "vëllazërore", "preferenciale", që e mban jashtë Kosovën edhe në kushtet kur kemi agresionin më të pashembullt pas Luftës së Dytë Botërore dhe kur në krah të tij, në mënyrë të veçantë, është vendosur i vetmi shtet që është Serbia, sigurisht që do ta bënte këtë rezolutë pa zemër, pa përmbajtje dhe, sigurisht, një rezolutë të përgjithshme, hipokrite që nuk demonstroi atë rol që duhet të ketë Shqipëria në këtë rast konkret.

Për të mos ju marrë më kohë, në rast se ne marrim një pozicion të tillë të fortë principial dhe luajal, vërtet mund ta bëjmë dhe në atë të voglën tonë, hapësirën tonë të vogël, atë rol që ne na duhet si një faktor stabiliteti në Ballkanin Perëndimor dhe në Ballkan në tërësi, të cilin, nëse do të vazhdojmë me këtë dashurinë pa fund për një Serbi në krah të agresorëve, e cila ka qenë pararendëse e Ukrainës me agresionin e saj në Kosovë e që nga ajo ditë nuk ka ndryshuar asnjë milimetër, atëherë do të dilnim dhe do të demonstroheshim qartë si një shtet pa parime, një shtet që udhëhiqet nga interesa të panjohura, por jo të qarta, jo të pastra dhe, së dyti, do të vazhdonim të legjitimonim një afërsi të jashtëzakonshme, ndërkohë që jemi dy botë të ndara.

Asnjë nga ne këtu në tavolinë nuk mund të vërë më në diskutim që ajo, që shqiptarët e kanë shumë të qartë, për të cilët nuk ekzistojnë as dallimet politike, as partiake, asgjë tjetër, por është orientimi perëndimor. Kurse Serbia dhe gjithçka, mënyra se si përjetohet, është një orientim diametralisht i kundërt me tonin.

Ndodhi një gabim shumë i rëndë, i qëllimshëm që ka qenë ndërtimi me kokëfortësi i "Ballkanit të hapur". Nuk është mirë që ky moment është kaq tragjik dhe kaq i rëndë, por është momenti për t'u korrigjuar. Çdo ditë e kaluar dhe vazhdimi në të, përveçse na rëndon dhe na shëmton si shtet, njëkohësisht, edhe na i komprometon në afatgjatë raportet me aleatët tanë euroatlantikë.

Mirënjohje për kohën që më dhatë!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Vasili!

Urdhëroni, zoti Shehu!

Tritan Shehu – Unë nuk e di se është procedura për sot në komision. Do të japim mendim, apo do të lihet për seancën plenare? Nuk e kam të qartë, sinqerisht, e them.

Mimi Kodheli – Zoti Shehu, ne këtu do të diskutojmë draftprojektrezolutën e paraqitur nga dakordësia me grupet parlamentare. Ju keni ndjekur një procedurë të rregullt dhe ajo do të diskutohet në seancë plenare, ashtu siç ju e keni paraqitur.

Tritan Shehu – Po kjo sot kërkon miratimin e komisionit?

Mimi Kodheli – Jo domosdoshmërisht. Vetëm mendim.

Tritan Shehu – Dakord.

Kjo rezolutë që ka paraqitur zoti Balla, do të diskutohet, apo kalon pa diskutim në seancë?

Mimi Kodheli – Atëherë, jua them edhe një herë, kolegët juristë thonë që duhet të kalojë me votim projektrezoluta...

Tritan Shehu – Me diskutim, apo pa diskutim fare?

Mimi Kodheli – Me diskutim.

Tritan Shehu – Edhe kjo e Taulantit?

Mimi Kodheli – Patjetër.

Tritan Shehu – Nuk ka kërkuar mocion me debat dhe ajo kalon direkt pa diskutim. Ja ta pyesim si e ka kërkuar.

Mimi Kodheli – Besoj se kalon vetëm me votim, pa diskutim.

Taulant Balla – Konferenca e Kryetarëve ka diskutuar për këtë çështje, në vijim edhe të një diskutimi të iniciuar nga zoti Çollaku dhe është lënë që, në rakordim edhe me Ministrinë e Jashtme, të përgatitet edhe një dokument që nuk është i asnjë grupi parlamentar. Edhe prezantimi im këtu ishte një nevojë, domethënë njëri prej atyre të katërve, se, po të ishte zoti Alibeaj, do ta lexonte ai, mund ta lexonin zonja Doda apo zoti Mediu. Për ta tejkaluar këtë pjesë, theksoj se Konferenca e Kryetarëve është i vetmi autoritet dhe nuk vjen nëpër komisione më; po u shpreh ajo, shkohet në seancë, por këtë lloj vakuumi, do ta quaja unë, të Rregullores sonë, sepse djemtë thonë se mund ta rregullojmë me 18/1-shin për kompetencat që kanë komisionet e përhershme, por të gjithë ne, që jemi paksa më të vjetër këtu, e dimë që, kur ka një çështje të politikës së

jashtme, pa u mbledhur Komisioni i Politikës së Jashtme, nuk e kalon dot dhe, për këtë qëllim, amendamenti i zotit Vasili, natyrshëm do të hidhet në votim këtu. Nëse ne refuzojmë këtu, natyrshëm pastaj ka të gjithë të drejtën t'ia paraqesë edhe seancës. Ia ka paraqitur seancës, se ai vetëm atje ndalon, kështu që, edhe sikur të mos duam, ai do t'i shkojë seancës. Ju, zoti Vasili, të gjithë këtu e dimë këtë punë që...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mimi Kodheli – Zoti Shehu, nëse nuk jam gabim, forma e paraqitur e draftprojektrezolutës nga 4 grupet parlamentare nuk kërkon mocion me debat, paraqitet, votohet, shkon në seancë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem!

Po, zoti Shehu, më pas zoti Çollaku dhe zoti Alizoti, nëse ka nevojë.

Tritan Shehu – Unë e dëgjova zotin Balla. Në fakt, e kisha lexuar edhe përpara materialin që ai paraqiti. Duke u ndodhur përpara një situatë me gjithë mend të rëndësishme dhe delikate të vendit tonë, prandaj kërkova që në fillim se jemi të gatshëm të negocionim si grup, grupi ynë për të arritur në një formulë të përbashkët, me një rezolutë të përbashkët që, me sa pashë, u refuzua.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, kjo është e drejtë e autorëve ta pranojnë, të mos e pranojnë, të negociojnë, të mos negociojnë, nuk kam asgjë, ashtu siç është e drejta jonë të mbrojmë rezolutën që kemi paraqitur ne.

Unë e kuptoj zotin Balla që tani...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord! Unë e kuptoj zotin Vasili që t'ia bashkëngjitet rezolutës tonë, e cila e ka krejtësisht këtë gjë, këtë element dhe jam i bindur që do t'ia bashkëngjitet, por, gjithashtu, e nxis dhe inkurajoj të kërkoj këtë amendament për rezolutën tuaj. Proceduralisht, unë e mbështes zotin Vasili.

Mimi Kodheli – Atëherë, le të dakordësojmë që vendimmarrja jonë të jetë sa më pranë Rregullores së Kuvendit. Sot unë, në kushtet e konsulencës së juristëve, ekspertëve të Rregullores, më duhet të ndaj me ju diçka: sot diskutohet, si produkt i Komisionit të Politikës së Jashtme, projektrezoluta e dakordësuar midis grupeve parlamentare, mbi të cilën ju keni të drejtë

të bëni komentet tuaja, meqenëse jeni pjesë e Komisionit të Jashtëm, ndërsa zoti Vasili nuk ka të drejtë vote, sepse nuk është anëtar i këtij komisioni. Duke thënë këtë, besoj se nuk do të ketë nevojë të hidhet në votim amendimi i zotit Vasili, sepse kalon automatikisht në seancë, ashtu siç kalon automatikisht në seancë edhe draftprojektrezoluta e paraqitur prej jush, zoti Shehu. Jam e saktë?

Petrit Vasili – Juristët tuaj kanë marrë përsipër një detyrë shumë të vështirë.

Mimi Kodheli – Të lutem!

Po lexoj atë që keni kërkuar.

Zoti Vasili, ju u jeni referuar dy neneve të ndryshme të Rregullores, ju dhe zoti Shehu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Vasili, të lutem! Jua jap fjalën, më vjen keq! Zoti Vasili i jeni referuar nenit 99, pika 3, të Rregullores së Kuvendit. Zoti Shehu i jeni referuar nenit...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A mundem të mbaroj! Zoti Vasili, nuk kam nevojë për konsulencë, sepse kam këtu letrat zyrtare, të cilave ju u jeni referuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Vasili, i jeni referuar nenit 99, pika 3, të Rregullores së Kuvendit. Zoti Shehu i është referuar nenit 98, pika 1, të Rregullores së Kuvendit. Për aq kohë sa argumentimi juaj ka qenë amendim, ndërsa, zoti Shehu ka mocion me debat në Kuvend, janë dy nene të ndryshme. Kjo është diferenca. Nëse doni ta tejkalojmë bazën ligjore, mbi të cilën juve u jeni referuar dhe i keni kërkuar Kuvendit të dyja këto gjëra, jeni më shumë sesa të lutur ta hedhim në votim, si amendimin, si propozim, si propozim tjetër. Nëse doni, i bëjmë të tria pa as më të voglin dyshim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të votohet. Kalon në komision. Do të shkojë si propozim i Komisionit të Politikës së Jashtme, zoti Shehu, kjo që jemi duke diskutuar tani; kjo që është dakordësuar.

Petrit Vasili – Zonja kryetare, për procedurë, meqenëse m'u referuat. Neni që rregullon muhabetin e rezolutave, po e divulgj, thotë: "Amendamenti me shkrim për projektrezolutën (kjo është projektrezolutë, nuk është miratuar në seancë, apo jo) duhet të jetë regjistruar në Sekretariatit për Procedurat dhe Votimin, të paktën 24 orë përpara"; gjë që ka ndodhur. Nuk është bërë në zyrë, por është bërë nëpërmjet Kryetares së Kuvendit, sepse nuk kishte zyra operative, sepse ishte ditë e diel. Defekt i organizimit të procedurës nga ana e Kuvendit, por

nuk po qëndrojmë te kjo çështje. E kemi kapërcyer këtë gjë. Referimi im është shumë i saktë. Kush thotë se nuk...

Mimi Kodheli – Nuk thashë se nuk është i saktë referimi juaj, thashë se është i ndryshëm nga referimi i zotit Shehu si procedurë.

Petrit Vasili – Shumë e vërtetë, por nuk kam vërejtje për këtë gjë fare.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mimi Kodheli – Po, zoti Çollaku, jua kam dhënë deri tani fjalën një 3 herë. Ju lutem, nuk është se duhet të ankoheni për këtë gjë, në një kohë që mund t'ia japim fjalën edhe dikujt nga ana e maxhorancës.

Më pas zoti Koçi.

Kreshnik Çollaku – Zonja kryetare, kam një opinion për projektin e propozua dhe një propozim, por po e bëj në fund. Lidhur me projektin dhe me ato që kolegët e mi, zoti Shehu dhe zoti Vasili propozuan, kush merr përsipër ta hartojë apo ta mbajë qëndrime të tilla, gjëja e fundit në një situatë të tillë do të ishte që parlamenti ynë të mos shkojë i unifikuar në dënimin e agresionit rus, më e rënda do të ishte që kjo rezolutë të mos ketë 140 vota në sallë.

Lidhur me “*Open Balkan*”, minishengenin, unë kam qenë nga njerëzit që në rekordet, që në seancën e parë qeverisë i kam kërkuar daljen e Shqipërisë nga minishengeni. E kam ripërsëritur kërkesën për të dalë Shqipëria nga “*Open Balkan*” edhe para 3 javësh. Mendoj se ky qëndrim, kjo sjellje, përveçse ka dëmtuar interesat e Kosovës, Shqipërisë, përbëri edhe një ndarje të thellë në politikën tonë të jashtme që prej 30 vjetësh të paprecedentë, asnjëherë në politikën e jashtme nuk kemi qenë kaq të ndarë, kaq në pozicione të kundërta, sa “*Open Balkan*”. Prandaj çdo orë për të dalë prej andaj, në seancën e fundit kam thënë: “Dilni shpejt me nder, se mund të vijë një moment që mund të dilni me turp”. Situatat po e çojnë drejt daljes me turp. Në pozicionin e Serbisë, me agresionin karshi Kosovës, me destabilitetin që e rrezikon, do të detyroheni të dilni me trup.

Qëndrimi ynë është i qartë i palëvizur në këtë pikëpamje, por, kur shkojmë të bëjmë qëndrime të përbashkëta, miqtë e mi, unë nuk ia dola dot t'i bind ta fusin “*Open Balkan*”. Në rast se ju ia dilni me amendamentin tuaj, vota ime dhe mbështetja ime për ta futur edhe “*Open Balkan*”-in është maksimale.

Çështja është që jo për këto motive ne duhet të dalim si një parlament që vonon apo përçahemi në qëndrimet kundër agresionit rus. Ky është shqetësimi.

Zonja kryetare, kam edhe një propozim lidhur me projektrezolutën për çështjen e Kosovës. I kuptoj pengesat procedurale, por, në rast se e mirëkuptoj këtë gjë dhe ju ftoj t’i nxitim këto, ju propozoj që ndërsa këto procedurat t’i kryejmë me shpejtësi për ta diskutuar në seancë, a mundemi sot si komision ta diskutojmë dhe të marrim një vendim të përbashkët për projektrezolutën për Kosovën që unë depozitova? Ju kërkova ta fusim në seancë. Më thoni, se është çështje procedure. Hajdeni t’i bëjmë. A mund ta lexoj? A mund ta diskutojmë? A mund të marrim opinione që, pasi të kryhen procedurat, të mos humbet asnjë orë kohë dhe të kalojë projektrezoluta për Kosovën?

Mimi Kodheli – Zoti Çollaku, ju falënderoj për pyetjen!

Përgjigjja ime është kjo: unë do të kisha dashur shumë që unë të mundesha ta bëja këtë gjë. Ne mund të diskutojmë këtu lirshëm për shumëçka, por për gjëra serioze kërkohen procedura serioze. Po ju them, problemi ka qenë atje. Mund ta kishit propozuar këtë gjë ditë më përpara. Kam të gjithë dëshirën dhe vullnetin e mirë për ta bërë këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem, patjetër, ne nuk mund të planifikojmë se çfarë do të ndodhë nesër e pasnesër dhe do të na duhet një projektrezolutë tjetër, por kjo është një gjë në dinamikë. Në dinamikën që përballen të gjithë, besoj se ne nesër mund të mblidhemi rishtas për ta diskutuar këtë gjë dhe mundet ta kalojmë (po e them edhe një herë që marr një tagër që nuk më takon) në seancën plenare të ditës së enjte. E bëjmë me seriozitet, ashtu siç e meriton dhe ashtu siç duhet.

Dakord, duke thënë këtë, përpara se t’ia jap fjalën zotit Koçi, kemi dakordësuar, edhe një herë e ritheksoj bazuar në dy procedura të ndryshme, mbi të cilat janë bazuar kërkesat për amendim apo për mocion me debat të kolegut Vasili dhe kolegut Shehu. Kolegu Vasili është në të drejtën e tij të amendojë dhe të paraqesë propozimin për amendim.

Mendimin e zotit vasali do ta votojmë në komision të parin, pastaj do të kalojmë me miratim në komision rezolutën e dakordësuar me grupet parlamentare.

Fjalën e ka zoti Koçi dhe më pas zoti Alizoti.

Petro Koçi - Faleminderit!

Së pari, i bashkohem vlerësimit që në procedurë sot kemi vetëm projektrezolutën e dakordësuar, që vjen nga 4 grupet parlamentare, dhe natyrshëm bëhet pjesë e diskutimit edhe amendamenti që ka paraqitur zoti Vasili. Çdo diskutim tjetër është përtej rendit të sotëm të ditës.

Natyrisht, për çdo interes tjetër që ka, qoftë ndonjë individ ose anëtar i parlamentit ose grup parlamentar, besoj se duhet të investohet në përputhje me Rregulloren, brenda një procedure që, natyrisht, i ka gjithmonë hapësirat për të kaluar sa më shpejt që të jetë e mundur.

Gjithashtu, më lejoni të shpreh mbështetjen absolute për draftin e dakordësuar të projektrezolutës lidhur me situatën e krijuar pas agresionit rus në Ukrainë. Unë mendoj se ky është një mesazh i qartë i unifikimit të të gjitha partive politike, grupeve parlamentare sa u përket këtyre zhvillimeve të jashtëzakonshme. Jam dakord me vlerësimin se që, pas Luftës së Dytë Botërore, ky është një moment shumë i rëndë, është cenuar rëndë integriteti territorial dhe sovraniteti i një shteti, siç është Ukraina, që po shoqërohet edhe me krime të rënda lufte, jo vetëm më operacione të mirëfillta ushtarake, që janë të dënueshme nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës.

Lidhur me amendamentin e zotit Vasili, mendoj se kjo nuk është një përpjekje për të dalë në Kuvend me një zë të unifikuar, është qartazi një përpjekje për ta kompromentuar këtë si qëllim.

Unë mendoj se një debat i kësaj natyre në parlament do të na nxirrte në opinionin publik, por edhe në rajon dhe përballë opinionit ndërkombëtar me zëra të ndryshëm, që, sipas mendimit tim, për momentin ky do të ishte mesazhi më i gabuar, pra nëse ne do të konfliktoheshim politikisht në parlament lidhur me këtë situatë.

Sigurisht, unë i di shqetësimet që janë shfaqur nga opozita për “Ballkanin e hapur”, i cili nuk është amnisti për të gjithë ata që kanë kryer krime në rajon dhe nuk është thelbi i politikës së jashtme të Shqipërisë, por “Ballkani i hapur” është vetëm njëri nga instrumentet. Shqipëria dhe shqiptarët e kanë dëshmuar gjithë këto vite se janë faktor paqeje dhe stabiliteti në rajon dhe mendoj se kjo është politika më e drejtë sa i përket Kosovës.

Kosova me ose pa “Ballkanin e hapur” është marrëdhënia jonë preferenciale absolute. Nuk mund të krahasohet asnjë marrëdhënie jona me çdo shtet tjetër në botë. Unë mendoj se, pavarësisht rezervave që mund të kenë zërat politikë në parlament, ne duhet të bëjmë atë që është kryesorja, ne duhet të bashkohemi në çështjen për projektrezolutën sa i përket situatës në Ukrainë. Besoj se ky do të ishte një mesazh i drejtpërdrejtë sa u përket pikëpyetjeve, zhvillimeve të ndryshme negative në rajon. Sigurisht, ne jemi të hapur për të shqyrtuar edhe ndonjë projektrezolutë, që mund të lidhet drejtpërdrejt me rajonin, siç është rasti i asaj që ka paraqitur zoti Çollaku. Unë nuk e kam lexuar atë që ka paraqitur zoti Çollaku, por mendoj se thelbësore

për momentin është kjo: ne të përqendrohemi, të jemi në një zë unik lidhur me atë që po ndodh në Ukrainë. Ky do të ishte një mesazh shumë i qartë për çdokënd në rajonin tonë, që mendon se nën kujdesin ushtarak rus mund të bëjë ato që ka bërë në të kaluarën në rajon.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjala për nënkryetarin, për zonjën Gjylameti dhe për zotin Vasili.

Tomor Alizoti – Mendoj se do të ishte me të vërtetë një gjë e mirë që të ishin të gjitha votat e parlamentit për një qëndrim ndaj Ukrainës, por meqë ne jemi një vend i çuditshëm, edhe vendimet tona janë të tilla. Për politikën e jashtme duhet të ketë një qëndrim fiks. Unë mendoj se, meqë personalisht, pra po e shikoj si puna e versionit të Putinit, që gjithandej bën përçarje, kurthe e gjëra, unë nuk jam i informuar për gjërat, dhe kjo nuk ka të bëjë me ju, por me mua dhe me grupin ku bëj pjesë unë. Unë mendoj se, po citoj edhe një thënie të Karl Bildit, i cili është një nga politikanët më në zë të politikës së jashtme në Europë, që thotë se për vende si Serbia, të cilat nuk ndajnë vlera të përbashkëta me ne, nuk mund të jenë pjesë e vlerave tona.

Meqë ne jemi në politikë dhe duhet të sqarojmë disa gjëra, “Open Balkan” ka qenë një refren i tërë kohës për Shqipërinë dhe rajonin. Vendi që ka bazë në Nish me Rusinë është Serbia, vendi që në vitin 2017 ka marrë 6 “MIG” 29 S të apdeituar nga ministri i Mbrojtjes ruse, Sergei Shougun, i cili i drejton operacionet ndaj Ukrainës sot, është prapë pjesë e këtij vendi, që është “Ballkani i hapur”. Unë personalisht, duke u nisur për interesat shqiptare, sepse përfaqësoj Shqipërinë, do të doja që dalja nga “Ballkani i hapur” nuk ka humbje politike, nuk ka asgjë. Mund të ketë një Ballkan tjetër me fqinjët, ku të jetë edhe Kosova brenda. Do ta miratoja këtë gjë, duke shfrytëzuar këtë moment, sepse pika e dytë, pas krizës së Ukrainës, do të jetë Ballkani dhe ne duhet të qartësojmë interesat tona në Ballkan dhe të kemi një strategji mbi ne. Çdo kohë, çdo minutë i qeverisë ose politikës shqiptare në këtë situatë kaq të vështirë për Ballkanin, çdo sekondë marrjeje me Serbinë, është cenimi i madh i interesave shqiptare.

Unë do të doja që këtu si pikë të ishte edhe “Ballkani i hapur” dhe unë do ta mbështesja me gjithë fuqinë time.

Mimi Kodheli - Faleminderit!

Para se t’ia jap koleges Gjylameti fjalën, më lejoni të rikujtoj që duhet të lexojmë më mirë se në çfarë dokumentesh është bazuar projektrezoluta. Gjithashtu, do të shtoja një koment, kjo projektrezolutë është absolutisht në përkrahje të plotë të rezolutës së Asamblesë së

Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara të datës 1 mars të këtij viti dhe, në mënyrë absolute, në përkrahje të rezolutës së Parlamentit Europian po të datës 1 mars të po këtij viti kundër agresionit rus ndaj Ukrainës.

Pra, linjat politike e politikës së jashtme të sigurisë së BE-së, përfshirë këtu sanksionet e ndërmarra ndaj Rusisë si BE, përfshirë këtu edhe qëndrimin politik të NATO-s, ku Shqipëria bën pjesë, janë absolutisht të sanksionuara në këtë projektrezolutë. Pra, jemi në një zë me çka lexova dhe me çka u lexua nga kryetari Balla.

Kjo ishte vetëm për të ritheksuar këtë dhe për të sqaruar opinionin publik.

Zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – Faleminderit!

Unë do të doja të ndaja me kolegët disa nga elementet, për të cilat ndihem keq që vijojmë të humbasim kohë këtu, që janë çështje për të cilat ne bashkohemi dhe nuk duhet të jemi të ndarë. Ajo që na bashkon sot, maxhorancë dhe opozitë, është shumë më tepër se ajo që na ndan. Sot ne duhet të jemi njëzëri në mbështetje të asaj që ndodh në Ukrainë. Sado të duket larg, është kaq afër realiteti i tyre, aq sa përfardojnë me Luftën e Parë ose Luftën Dytë Botërore dhe sot po e shohim si realitet. Të rikthejmë sot në tryezën e diskutimeve ato që janë elementet e veçanta që na ndajnë, për mua do të thotë të vonohemi në dënimin e atij agresioni, që është ndër agresionet më të mëdha që kanë ndodhur në 100 vjetët e fundit.

Ne duhet të mendojmë si duhet ta përmirësojmë këtë lloj rezolute. Po, kemi hapësira për t'i respektuar ose t'i përdorur të gjithë mekanizmat që na jep Rregullorja e Kuvendit për ta bërë të mundur këtë. Të mendojmë si mund të jemi një zë, madje e dëgjova nga zoti Çollaku shpeshherë këtë fjalën “të kemi një rezolutë të mbështetur në 140 vota”. Ne rezolutën duhet ta kemi me 140 vota. A jemi pro apo kundër “Ballkanit të hapur”, kjo është një çështje që duhet diskutuar kur të kemi momentin tonë, por sot ne po diskutojmë për të dënuar atë që po ndodh në Ukrainë.

Sot në mëngjes unë u zgjova me gjërat më të rënda që mund ta kisha parë ndër vite, te shikoja dy prindër, me fëmijën 18 muajsh në krah, për mua është shumë e rëndë si nënë që sot të diskutoj këtu a jemi pro apo kundër “Ballkanit të hapur”. Ne duhet të jemi në dënim të saj që po ndodh në Ukrainë. Nesër mund të ulemi serish së bashku dhe të diskutojmë atë që po ndodh me “Ballkanin e hapur”, jemi pro, kundër, mund të ndryshojmë apo mund të përmirësojmë.

Sot ne po diskutojmë atë që po ndodh në Ukrainë, ku po vazhdojnë bombardimet rregullisht. Nuk po bombardohen më as objektet ushtarake, as pjesa e ushtrisë së Ukrainës, por po bombardohen civilët. Ne sot duhet të jemi në mbështetje të tyre. Nuk duhet të diskutojmë këtu nëse është një procedurë që duhet diskutuar tre ditë përpara apo janë bashkuar të katër grupet parlamentare apo jo, a kemi një amendament apo kemi edhe një përmirësim më tej, kjo është një çështje relevante përkundrejt asaj që duhet të bëjmë.

Është e vërtetë ajo që thatë pak më parë, zoti Shehu, duhet ta kishim bërë që në momentin e parë rezolutën, e morëm kohën për ta bërë, që të kishim edhe dakordësinë. Nëse ne vijojmë të vonojmë këtu sot, nuk është se do të ndodhë ndonjë gjë kushedi se çfarë, por, ama së paku, që të jemi solidarë në atë që na takon si Shqipëri, duhet të jemi si deputetë. Ne nuk jemi votuar për çfarë na ndan, por për interesat e kombit dhe, mbi të gjitha, për atë që është solidariteti për jetën njerëzore. Besoj se nuk do ta kemi mundësinë ndonjëherë më, edhe pse është një fatkeqësi shumë e madhe që kemi këtë lloj mundësie sot, për të treguar se jemi bashkë, në respekt të vlerave njerëzore, shumë më tepër se sa është ndasia politike. Kështu që, do t'ju kërkoja, si një nënë, që të mos merremi me pjesën e ndasive, por me atë që na bashkon, që është respekti për vlerën e jetës së njerëzve. Ne duhet të jemi për këtë. Nesër, pasnesër ose të enjten të vijmë prapë dhe të diskutojmë çfarë mund të bëjmë më shumë ende, përtej pjesës si jemi, në respekt të atyre që janë sanksionet e Kombeve të Bashkuara, sanksionet që ka marrë BE-ja, që ne jemi në linjë me ta, por, qoftë edhe duke vijuar më tej ,në kuadër të atyre që janë ndryshimet e orëve të fundit, në lidhje në çfarë vendi renditet sot Shqipëria për Federatën Ruse.

Pra, ta kalojmë këtë që është e para, se ju thatë që jemi të vonuar, le të mos vonohemi më, duke tentuar që t'i pengojmë bashkë ato që janë ndasitë politike.

Ju faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, koleges Gjylameti, për sensibilitetin! E vlerësoj!

Kolegu Vasili ka fjalën, më pas fjala për kolegun Shehu. Besoj se janë komentet tuaja të fundit dhe pastaj e hedhim në votim.

Ju faleminderit!

Petrit Vasili – Së pari, procesi parlamentar që po shqyrtojmë nuk bën dallim nga procesi parlamentar që ne ushtrojmë në të gjithë veprimtarinë e parlamentit, në këtë komision apo kudo tjetër.

I gjithë procesi i shqyrtimit këtu, është një proces pasurimi dhe përmirësimi. Nuk besoj se e kemi shndërruar parlamentin në një proces konfirmimi, ku mbyllim sytë dhe pastaj ecim para.

Sa i takon rezolutës, për të qenë fare të qartë, në draftrezolutën e dakordësuar nuk bëra asnjë koment të vetëm, dhe u bëj thirrje të gjithë kolegëve që të moskeqinterpretojnë, është një lojë politike shumë e vjetër kjo, dhe nuk është fare për këtë tavolinë, ka 30 vjet që është konsumuar, nuk u diskutua për këtë përmbajtje, le të rrijë ajo përmbajtje që është atje, dhe nuk kam kundërshtime, por në rast se ka një plotësim jetik, në të cilin parlamenti shqiptar ka shumë frikë të citojë Serbinë, kur rezoluta e Parlamentit Europian shpreh keqardhjen shumë të madhe për Serbinë dhe i vë emër e mbiemër, ne e kemi partnerin tonë të dashuruar, ne i kemi kushtuar tonelata fjalë të politikës së jashtme “Open Balkan”-it dhe kjo është vija ndarëse në këtë mes.

Kolegu Alizotaj referoi edhe një personalitet të madh, që është Karl Bilti, por ama kemi edhe një dokument, me 636 vota, këtë rezolutë kemi, e nuk refletoakemi dot ne. Po këtu nuk kemi ndasi fare ne, jemi të gjithë të bashkuar në rezolutën dhe do t’i bëjmë edhe një plotësim parimor, për të treguar qartë që ne me këta që përkrahin agresorët, këta që kanë lënë urë lidhëse Beograd-Moskë për avionët, këta që nuk kanë asnjë embargo për ta, këta që e kanë *Swift*-in e hapur për ta, pra që i mbështesin ata, nuk kanë punë me ne në këtë moment, kanë marrëdhënie preferenciale, marrëdhënie të fqinjësisë së mirë, bashkëpunim ndërshtetëror, gjithçka të vazhdojë, por iniciativa preferenciale të tilla s’mund të jenë, sepse këta kanë qenë dhe janë i vetmi frymëzim negativ dhe agresiv, po të doni, në raport me Kosovën, që ne kemi përzemër.

Jo më kot Europa thotë (ne duhet të hapim sytë, nuk jemi këtu për të bërë patetizma): “Rreziku nga Ukraina mund të zbresë në Ballkan” dhe ajo që është detonatore në Ballkan, është Serbia. Ne i themi stop kësaj marrëdhënie, se këtë po kërkojmë, dhe u japim një mesazh të gjithë atyre, me të cilët ne jemi vënë në një krahë, aleatët Euroatlantikë, që bashkë me ta të vazhdojmë të mbajmë këtë pozicion edhe sikur të na kushtojë, në rastin konkret kemi, një favor që nuk na kushton ekonomikisht fare, se u provua që, meqë ka keqardhje për njerëzit e varfër, ky “Open Balkan” i mjeroi ata fermerët dhe i keni parë se çfarë po ndodh me ta, se rrugëve i keni. Pra, edhe ekonomikisht vetëm fitojmë, nuk humbasim.

Pra, për ta mbyllur dhe për të mos ju marrë kohën e çmuar, sepse do të shkojmë edhe në seancë, amendamenti është një plotësim thelbësor i kësaj, nuk na ndan, por na bashkon, na çon te 140 vota dhe na ndan nga ata që përkrahin, janë frymëzues dhe që thonë se kanë Rusinë mëmën

e tyre dhe nuk kanë tjetër. Kush nuk e mban këtë pozicion është më afër atyre, larg Kosovës dhe larg euroatlantizmit. Kjo është fare e qartë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Vasili!

Zoti Shehu.

Tritan Shehu - Zonja kryetare, faleminderit!

Zoti Balla, si kolegë të vjetër që jemi, fatkeqësisht, rezoluta që ju keni paraqitur, se ju e keni paraqitur, pavarësisht ngjyrave që doni t'i jepni, si puna e Rosisë, e cila kërkon t'i marrë të gjitha, është e zbehtë. Jua them këtë shumë sinqerisht. Rezoluta nuk prek çështje thelbësore dhe nuk prek atë, e cila është realisht vendi dhe pjesa ku mund të kemi rol. Ne nuk mund të kemi rol as në Europën Qendrore, as diku tjetër, sepse këto janë dimensionet tona, e vetmja hapësirë ku ne mund të kemi rol dhe që, fatkeqësisht, po rrezikohet të shkohet drejt stabilizimit, është rajoni ynë. Jo më kot u prek qartësisht me një nen të veçantë, nen 38, në rezolutën e Parlamentin Europian, duke i vënë edhe emër dhe mbiemër, siç tha edhe deputeti Vasili, jo më kot edhe të gjitha institucionet ndërkombëtare po vënë theksin te rreziku i destabilizimi të Ballkanit Perëndimor, duke filluar që nga Bosnja, dhe ne heshtim për këtë gjë. Pse? Sepse kemi frikë të mos i ngelë hatri Vuçiçit. Se kemi frikë mos na mërzhitet ai. Nuk është kështu, ne duhet të mbajmë qëndrimin tonë, duhet të jemi qartësisht solidarë, të paktën me Parlamentin Europian. Ata përmendin shtëpinë tonë, vënë gishtin te problemi i shtëpisë sonë, ndërsa ne guxojmë të përmendim emrin e atij që rrezikon shtëpinë tonë. Është shtëpia jonë këtu.

Pra, këtë e konsideroj një mangësi të madhe të rezolutës që ju keni paraqitur, për gjërat e tjera nuk kam asnjë vërejtje, dua të jem shumë i sinqertë me ju, kam një vërejtje për një nen lidhur me rolin e qeverisë, por ajo është një mbërtheckë e vogël, që rregullohet, po të ketë vullnet.

Dua t'ju kujtoj diçka. Sipas të gjithë traditës që kemi pasur në parlamentin tonë prej vitesh, ka një traditë të tillë, që kur paraqitet një rezolutë nga një grup prej 7 vetash, pastaj kur del një projektrezolutë tjetër nga një pjesë tjetër, qoftë edhe nga 3 grupe parlamentare, s'ka asnjë rëndësi, në qoftë se ekziston vullneti për të dalë së bashku me një rezolutë të vetme, ulet dhe negociohet dhe kërkohet kompromisi së bashku. Bëhet kompromisi për pikat që janë, për pikat që nuk janë lihen të shtohen si amendamente, që votohen një për një në parlament. Kjo është

praktika që ne kemi pasur deri më sot në parlamentin tonë. Unë këtë ftesë jua bëra që në fillim. Nuk u pranua, dakord, nuk ka problem.

Ne shkojmë tani në parlament, votojmë, nuk ka asgjë të keqe, kjo është një rrugë legale dhe krejtësisht kushtetuese. Kjo ishte praktika që ne kemi bërë historikisht në parlamentin tonë në rastin kur kemi pasur disa projektrezoluta, pavarësisht nëse u bë nga grup parlamentar apo nga grup deputetësh. Ka një vlerë ligjore legale.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Shehu!

Zoti Çollaku, pastaj zoti Balla.

Kreshnik Çollaku – Unë dua të theksoj edhe një herë se në situatën që jemi, duke parë të gjitha tekstet e rezolutave, që nga ato të BE-së, edhe vendeve të Ballkanit, Kosova, Maqedonia e të tjerë, ne nuk duhet të humbasim asnjë sekondë që ta kalojmë qëndrimin tonë dhe, mbi të gjitha, insistoj se ky qëndrim ka vlerë nëse ka 140 vota në parlament.

Kështu që, në rast se për të pasur 140 vota, pranohen edhe ato amendamentet, sidomos në rastin konkret “Ballkani i hapur”, ndajmë totalisht të njëjtën ide dhe opinion, unë do të isha edhe më radikal, po të doni, por rëndësi ka që të kalojë dhe të kemi konsensus të plotë në sallë. Rëndësi ka që rezoluta për agresionin rus në Ukrainë, që kërcënon Europën, do të ishte e turpshme për parlamentin tonë sikur të shkojmë me vota të thyera.

Këtë e bëj si apel për të gjitha palët. Në rast se ekziston vullneti nga ju, jam me të dyja duart dakord të futemi në “Ballkanin e hapur”, por rëndësi ka që të mos prekë 140 votat në sallë. Ky do të ishte një turp, që Shqipëria nuk ka pse e merr në kurriz.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Çollaku, për komentimin!

Zoti Balla, fjala për ju.

Taulant Balla – E para, lidhur me amendamentin e zotit Vasili, sikurse e thanë edhe dy kolegët e tjerë të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, zoti Koçi dhe zonja Gjylameti, më lejoni t’ju them që ne jemi kundër këtij amendamenti, sepse amendamenti nuk ka asnjë lidhje me projektrezolutën e propozuar.

Lidhur me traditën parlamentare, që përmendi zoti Shehu, po, por unë ua thashë që në fillim, propozimi juaj nuk ka asnjë lidhje me dokumentin e paraqitur. Si të tilla i propozoni vetë, unë dua që Kuvendi i Shqipërisë të mos humbë asnjë sekondë më, por të pozicionohet qartë kundër agresionit të Federatës Ruse ndaj një shteti të pavarur.

Kryetarja e Komisionit të Politikës së Jashtme ju përmendi që Shqipëria tashmë është pozicionuar në këtë aspekt, sepse në fund të fundit, ne ishim propozues dhe natyrshëm kemi votuar në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara një rezolutë të Kombeve të Bashkuara, ndërkohë në kontekstin që u përmend këtu, edhe në kuadër të marrëdhënies mes Kuvendit të Shqipërisë dhe Parlamentit Europian, edhe në kuadër të faktit që Shqipëria ka një politikë të jashtme 100% të përafuar me politikën e jashtme të BE-së, unë mendoj se e gjithë përqsja jonë e njëjtë e politikës së jashtme me dy aleatët tanë strategjikë, SHBA-të dhe BE-ja, na bëjnë të kuptojmë që do të kemi kohë plot t’ju shpjegojmë dhe mendoj se ne do t’ju bindim që “Ballkani i hapur” është një mundësi shumë e mirë për rajonin tonë për Shqipërinë, por ku është një diskutim tjetër.

Ju sollët negativitetin, ndërsa ne po ju sjellim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Siç edhe u dakordësuam, hedhim në votim amendimin e zotit Vasili. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Nuk miratohet.

Faleminderit, zoti Vasili, për prezencën!

Kalojmë me votimin e projektrezolutës së dakordësuar me grupet parlamentare. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit, kolegë, për prezencën dhe për diskutimet!

Shihemi në seancë në orën 17:00.

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretari
Etjen Xhafaj

Përgjegjësjë e Shërbimit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Këshilltari i komisionit
Genc Pecani